



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 14 tetor 2024
Nr. ref.:RK 2557/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI168/23

Parashtrues

E.M

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Pml.nr.466/2023] të 8 shtatorit 2023 të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktvendimin [PN1.DKR.nr.666/2023] e 26 qershorit 2023 të Gjykatës së Apelit, dhe Aktvendimin [PN1.DKR.nr.839/2023] të 10 gushtit 2023 të Gjykatës së Apelit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është dorëzuar nga E.M nga fshati Senoc komuna e Rahovecit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) i përfaqësuar nga Ylli Bokshi avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [Pml.nr.466/2023] të 8 shtatorit 2023 të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktvendimin [PN1.DKR.nr.666/2023] e 26 qershorit 2023 të Gjykatës së Apelit, dhe Aktvendimin [PN1.DKR.nr.839/2023] të 10 gushtit 2023 të Gjykatës së Apelit.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së mosveprimit të Gjykatës së Apelit dhe Supreme, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E Drejta për Proces të Rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22(Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 14 gusht 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 16 gusht 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes vendimit [Nr.GJR.KI168/23] caktoi gjyqtarin Enver Peci gjyqtar raportues dhe përmes vendimit [Nr.KSH.KI168/23] Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban, anëtarë.
7. Më 18 gusht 2023, Parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë disa dokumente shtesë.
8. Më 28 gusht 2023, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës, dhe kërkoi nga ai që të sjellë autorizimin që dëshmon se ai e përfaqëson parashtruesin e kërkesës në procedurën para Gjykatës.
9. Më 19 shtator 2023, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin për përfaqësim.
10. Më 27 shtator 2023, Gjykata i dërgoi një shkresë Gjykatës së Apelit dhe kërkoi nga ajo që të informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me procedurën që është duke u zhvilluar në lidhje me rastin e parashtruesit të kërkesës, ku sipas parashtruesit të kërkesës rasti ndodhet në Gjykatën e Apelit pasi që parashtruesi i kërkesës ka bërë ankesë kundër aktvendimit [2023:133768] të 12 korrikut 2023 të Gjykatës Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
11. Më 27 shtator 2023, Gjykata e Apelit përmes e-mailit zyrtar dorëzoi në Gjykatë aktvendimin [PNI.DKR.nr.666/2023] të 26 qershorit 2023 të Gjykatës së Apelit, por

nuk dha përgjigje lidhur me procedurën që është duke u zhvilluar në atë Gjykatë lidhur me ankesën kundër Aktvendimit [2023:133768] të 12 korrikut 2023 të Gjykatës Themelore.

12. Më 29 shtator 2023, Gjykata përmes e-mailit zyrtar, prapë i shkruajti administratorit të Gjykatës së Apelit, duke i përsëritur kërkesën e datës 27 shtator 2023, por nuk pranoi përgjigje.
13. Më 22 nëntor 2023, Gjykata pasi që nuk pranoi përgjigje nga Gjykata e Apelit, i dërgoi një shkresë Drejtorit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ku kërkoi nga ai që Gjykatës t'ia sigurojë informatat lidhur me procedurën që është duke u zhvilluar në Gjykatën e Apelit në lidhje me rastin e parashtruesit të kërkesës, i cili ka bërë ankesë kundër aktvendimit [2023: 133768] të 12 korrikut 2023 të Gjykatës Themelore.
14. Më 27 nëntor 2023, Gjykata e Apelit dorëzoi në Gjykatë disa dokumente në lidhje me rastin përfshi Aktvendimin [PN1.DKR.nr.666/2023] të 26 qershorit 2023 të Gjykatës së Apelit, por prapë nuk dha përgjigje lidhur me procedurën që është duke u zhvilluar në atë Gjykatë lidhur me ankesën kundër aktvendimit [2023:133768] të 12 korrikut 2023 të Gjykatës Themelore.
15. Më 22 janar 2024, Gjykata e Apelit dorëzoi në Gjykatë Aktvendimin [PN1.DKR.nr.839/2023] të 10 gushtit 2023.
16. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
17. Më 25 qershor 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri vendosi që të shtyhet për rishqyrtim në një seancë të ardhshme.
18. Më 4 shtator 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

19. Bazuar në shkresat e lëndës, më 14 qershor 2023, Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejshëm: PTHGJ) kishte paraqitur kërkesë [PP/I.nr.75/2023] për caktimin e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale Dhunimi nga neni 227 par.4 nën paragrafi 4.8 lidhur me paragrafin 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK) për arsytet e parapara në nenin 163 paragrafi 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPRK).
20. Më 15 qershor 2023, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PPr.nr.2023:133768] aprovoi kërkesën e PTHGJ dhe parashtruesit të kërkesës ia caktoi paraburgimin në kohëzgjatje prej një (1) muaj, i cili paraburgim do i llogaritej prej datës 13 qershor 2023 e gjer me datën 13 korrik 2023, në ora 15:10/h, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale Dhunimi nga neni 227 paragrafi 4 nën paragrafi 4.8 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së.
21. Më 16 qershor 2023, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimit [PPr.nr.2023:133768] të 15 qershorit 2023 të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes të dispozitave të procedurës penale, shkelje

të ligjit penal dhe vlerësimit të gabuar ose jo të plotë të fakteve mbi të cilat është nxjerrë aktvendimi, me propozimin që aktvendimi i atakuar të anulohet dhe të pandehurit ti ndërpritet menjëherë masa e paraburgimit, apo që i njëjti të ndryshohet duke i caktuar ndonjëherë prej masave më të buta për sigurimin e të pandehurit në procedurë.

22. Më 26 qershor 2023, Gjykata e Apelit përmes aktvendimit [PN1.DKR.nr.666/2023] refuzoi si të pa bazuar ankesën e mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës, ndërsa aktvendimin [PPr.nr.2023:133768] të 15 qershorit 2023 e Gjykatës Themelore e vërtetoi.
23. Më 4 korrik 2023, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër aktvendimit [PN1.DKR.nr.666/2023] të 26 qershorit 2023 të Gjykatës së Apelit dhe aktvendimit [PPr.nr.2023:133768] të 15 qershorit 2023 të Gjykatës Themelore.
24. Më 8 shtator 2023, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Pml.nr.466/2023] hodhi poshtë si jolëndore kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve lidhur me procedurën e dytë për vazhdimin e paraburgimit.

25. Më 12 korrik 2023, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [Ppr.Kr.nr.2023: 133768] vendosi që parashtruesit të kërkesës ti vazhdohet paraburgimi në kohëzgjatje prej 2 muaj, i cili do të llogaritet prej datës 13 korrik 2023 e gjer me datën 12 shtator 2023, në ora 15:10/h, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale Dhunimi nga neni 227 paragrafi 4 nën paragrafi 4.8 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së. Gjykata Themelore, vendimin për vazhdimin e paraburgimit e arsyetoi: *“ Sa i përket kushteve të posaçme, gjykata vlerëson se është i arsyeshëm propozimi i Prokurorisë Themelore në Gjakove - Departamenti për Krime të Renda, për vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurve nga arsytet e paraburgimit të parapara në kuptim të nenit 184 par. 1 nën par. 1.2 pika 1.2.1 të KPPRK-së, duke pasur parasysh se procedura ndaj të pandehurve E.M dhe A.G është në fazën fillestare dhe lartësia e dënimit e parashikuar për veprën penale Dhunimi nga neni 227 par.4, nën-par.4.8 lidhur me par.2 të KPRK-së, parashihet dënimi deri në pesëmbëdhjetë (15) vite burgim, andaj nëse të njëjtit lihen në liri ekziston rreziku që lehte të vendoset te arratisen dhe të jene të pa arritshëm për organet e ndjekjes”.*
26. Më 13 korrik 2023, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit [Ppr.Kr.nr.2023: 133768] të 12 korrikut 2023 Gjykatës Themelore për vazhdimin e paraburgimit, për shkak të shkeljes të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal dhe vlerësimit të gabuar ose jo të plotë të fakteve mbi të cilat është nxjerrë aktvendimi, me propozimin që aktvendimi i atakuar të anulohet dhe të pandehurit ti ndërpritet menjëherë masa e paraburgimit, apo që i njëjti të ndryshohet duke i caktuar ndonjëherë prej masave më të buta për sigurimin e të pandehurit në procedurë.
27. Më 10 gusht 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN1.DKR.nr.839/2023] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa aktvendimin e Gjykatës Themelore e vërtetoi.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës e konteston aktvendimin e Gjykatës së Apelit dhe Supreme, me pretendimin se i janë shkelë të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
29. Parashtruesi i kërkesës fillimisht pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, duke pretenduar shkelje të të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, pasi që siç thekson parashtruesi i kërkesës, Gjykata e Apelit nuk ka vendosur në afat ligjor si në rastin e ankesën kundër vendimit të parë për caktimin e paraburgimit, dhe vendimit të dytë që ende nuk ka sjell vendim, dhe me këtë: “ ... duke pasur parasysh që Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, sipas KPPRK-së, kanë afate të caktuara me orë për vendosjen e çështjes së paraburgimit, gjithashtu sipas KPPRK janë të detyruara të vendosin në me nguti të posaçme, ndërsa këtë nuk e kanë bërë, kanë shkelur par.2 të nenit 31 të Kushtetutës, lidhur me par.1 të nenit 6 të KEDNJ-së”.
30. Tutje parashtruesi i kërkesës thekson se “Duke pasur parasysh shkeljet që ju behën qytetareve te Republikës se Kosovës, lidhur me çështjen e paraburgimit, vërejtjet nga organizatat ndërkombëtare, Raporti i OSBE "Përdorimi i Paraburgimit ne Procedurat Penale ne Kosove: Shqyrtim dhe Analize Gjithëpërfshirëse e Bregave te Mbetura - Pjesa II -" Mars, 2010, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese te Republikës se Kosovës, Aktgjykim e Gjykatës Kushtetuese te Republikës se Kosovës, rastin nr.' KI10/15 te parashtruesit Fahri Deqani, Aktgjykim e Gjykatës Kushtetuese te Republikës se Kosovës, rastin nr. K155/22, te parashtruesit Sasha Spasiq dhe Konstatimeve ne Mendimin Konkurrues te Gjyqtarit Radomir Laban ne Rastin KL 55/22, te kësaj Gjykate, Gjykata Kushtetuese e Republikës se Kosovës duhet te vendos edhe ne këtë rast me aktgjykim marre parasysh shkeljet e nenit 31 te kushtetues e Republikës se Kosovës, përkatësisht gjykimit ne afat te arsyeshëm”.
31. Më tej parashtruesi i kërkesës kërkon mos zbulimin e identitetit, pasi që siç thekson “Duke pasur parasysh qe ne këtë çështje janë te përfshirë pale te mitura dhe te pandehurit janë ne një moshe te re dhe ne rast te publikimit te emrit te parashtruesit te kërkesës me hulumtimin ne google do te shfaqej emri i tij ne këtë çështje, me vlerësimin e fazës se procedurës duke pasur parasysh dhe prezumimin e pafajësisë i lutem gjykatës mos te publikoj emrat e palëve te përfshira ne këtë çështje penale”.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 29

[E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë]

1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim: (1) pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;

(2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj; (3) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij/saj në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm; (4) për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë;

(5) për hyrje të paligjshme në Republikën e Kosovës ose pas urdhrit të ligjshëm për largim ose ekstradim.

2. Çdokush që privohet nga liria, duhet të vihet në dijeni menjëherë, për arsyet e privimit, në gjuhën që ajo/ai e kupton. Njoftimi me shkrim mbi arsyet e privimit duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundshme. Çdokush që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës, brenda dyzet e tetë (48) orësh duhet të dërgohet përpara gjyqtarit, i cili vendos për paraburgimin ose lirinë e tij/saj, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur personi i privuar është sjellë para gjykatës. Çdokush që arrestohet, ka të drejtën që të nxirret në gjykim brenda një periudhe të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjykimit, me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e saj/tij para gjykimit.

3. Çdokush që privohet nga liria, duhet të njoftohet menjëherë se ka të drejtë të mos japë asnjë deklaratë dhe se ka të drejtë për mbrojtës sipas zgjedhjes së tij/saj dhe ka të drejtë që pa vonesë të informojë për këtë personin sipas zgjedhjes së vet.

4. Çdokush që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit.

[...]

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 5

(E drejta për liri dhe siguri)

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

a. kur burgoset ligjërisht pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;

b. kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për moszbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata në përputhje me ligjin ose për të garantuar përmbushjen e një detyrimi të parashikuar nga ligji;

c. kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një vepër penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;

[...]

2. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni duhet të çohet menjëherë përpara një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t'u paraqitur në procesin gjyqësor.
3. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.
4. Çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim.

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohej nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
2. Çdo person i akuzuar për një veprë penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

[...]

Kodi nr. 08/L-032 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (i publikuar në Gazetën Zyrtare më 17 gusht 2022)

Neni 184 (Kushtet e nevojshme për caktimin e paraburgimit)

1. Gjykata mund të caktojë paraburgim ndaj një personi vetëm nëse në mënyrë të qartë ka gjetur se:
 - 1.1. ekziston dyshim i bazuar se personi i tillë ka kryer veprë penale;
 - 1.2. përmbushet njëri nga kushtet e mëposhtme:
 - 1.2.1. kur ai fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë se ekziston rrezik i ikjes së tij;
 - 1.2.2. kur ka arsye për të besuar se ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo në bashkëpjesëmarrësit; ose
 - 1.2.3. kur pësia e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai

mund ta përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej.

1.3. masat më të buta për sigurimin e pranisë së të pandehurit të parapara në nenin 171 të këtij Kodi do të ishin të pamjaftueshme për të siguruar praninë e personit të tillë, të parandalojë përsëritjen e veprës penale dhe të sigurojë zbatimin e suksesshëm të procedurës penale.

[...]

Neni 186

(Përmbajtja e aktvendimit për caktimin e paraburgimit dhe ankesa kundër tij)

1. Paraburgimi caktohet me aktvendimin me shkrim i cili përfshin: emrin dhe mbiemrin e personit i cili paraburgoset dhe të dhënat e tij personale të njohura për gjyqtarin e procedurës paraprake; kohën e saktë të arrestimit; kohën e sjelljes te gjyqtari i procedurës paraprake; kohën e marrjes në pyetje për paraburgim; veprën penale për të cilën akuzohet; bazën ligjore për paraburgim; njoftimin për të drejtën në ankesë; dhe arsyetimin e të gjitha fakteve vendimtare që e kanë shkaktuar paraburgimin, duke përfshirë edhe arsyet për dyshim të bazuar se personi ka kryer vepër penale dhe faktet vendimtare nga neni 184, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 i këtij Kodi.

2. Aktvendimi mbi paraburgimin i dorëzohet personit përkatës, mbrojtësit të tij dhe prokurorit të shtetit. Koha e dorëzimit të aktvendimit personit përkatës shënohet në shkresat e lëndës.

3. Secila palë mund të paraqesë ankesë brenda dyzet e tetë (48) orëve nga koha e dorëzimit të aktvendimit. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit. Nëse ankohet vetëm njëra palë, gjykata ia dërgon ankesën palës tjetër e cila argumentet e veta mund t'ia paraqesë gjykatës brenda njëzet e katër (24) orëve, nga dorëzimi i ankesës. Për ankesë vendoset brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga paraqitja e përgjigjes, apo skadimi i afatit për parashtrimin e përgjigjes në Gjykatën e Apelit.

4. Kur gjyqtari i procedurës paraprake e refuzon kërkesën e prokurorit të shtetit për caktimin e paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhërojë cilëndo masë tjetër nga ky Kapitull.

[...]

Neni 188

(Vazhdimi i paraburgimit)

1. Paraburgimi mund të vazhdohet vetëm nga gjyqtari i procedurës paraprake, në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit, i cili tregon se ka bazë për paraburgim nga neni 184 i këtij Kodi, se ka filluar hetimi dhe se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e arsyeshme për të përshpejtuar zbatimin e hetimit. I dëmtuari apo mbrojtësi i viktimave mund të kërkojë nga prokurori i shtetit që të kërkojë vazhdimin e paraburgimit. Prokurori i shtetit ia dorëzon gjykatës kërkesën për vazhdimin e paraburgimit jo më vonë se pesë (5) ditë para skadimit të paraburgimit të caktuar me aktvendimin e fundit.

2. Kërkesa për vazhdimin e paraburgimit duhet t'i dorëzohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij në afatin jo më vonë se tri (3) ditë para skadimit të paraburgimit të caktuar me aktvendimin e fundit.

3. Ndaj çdo aktvendimi mbi vazhdimin e paraburgimit mund të ushtrohet ankesë. Neni 186, paragrafët 3 dhe 4, zbatohen përshtatshmërisht.

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”

34. Gjykata më tej i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.

35. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [PN1.DKR.nr.666/2023] të 26 qershorit 2023 dhe [PN1.DKR.nr.839/2023] të 10 gushtit 2023 të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimin [Pml.nr.466/2023] e 8 shtatorit 2023 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj si dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me ligj.
36. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
37. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 34 (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim:

Rregulli 34

(Kriteret e pranueshmërisë)

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”

[...]

38. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih, rastin e Gjykatës: KI04/21, parashtruese [Nexhmije Makolli](#), Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26).
39. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”. Këtë koncept të papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi e pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara” të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata i ka përvetësuar edhe në praktikën e saj gjyqësore përfshirë, por duke mos u kufizuar në, rastet KI40/20 me parashtrues [Sadik Gashi](#), Aktvendim për papranueshmëri i 20 janarit 2021; KI163/18, me parashtrues [Kujtim Lleshi](#), Aktvendim për papranueshmëri i 24 qershorit 2020; dhe KI21/21, me parashtrues [Asllan Meka](#), Aktvendim për papranueshmëri i 28 prillit 2021.
40. Në këtë kontekst, dhe në vazhdim, për të vlerësuar pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht për të vlerësuar nëse në rrethanat e këtij rasti kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht, do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilat, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
41. Gjykata rikujton se esenca e këtij rasti ndërlidhet fillimisht me kërkesën e PTHGJ-së për caktim të paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale Dhunimi nga neni 227 paragrafi 4, nën paragrafi 4.8 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së për arsyet e parapara në nenin 163 paragrafi 1 dhe 2 të KPPRK-së. Kërkesa e PTHGJ-së për caktim të paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji ishte miratuar nga Gjykata Themelore me arsyetimin se janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 184, paragrafin 1, nën paragrafët 1.1 dhe 1.2, pikën 1.2.1 të KPPRK-së, duke shtuar se ekziston dyshimi i bazuar se parashtruesi i kërkesës ka kryer veprat penale për të cilat dyshon PTHGJ. Aktvendimi i Gjykatës Themelore për caktimin e paraburgimit ishte miratuar nga Gjykata e Apelit, ndërsa Gjykata Supreme kishte hedhur poshtë si jo lëndore kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

42. Më pas, PTHGJ kishte parashtruar kërkesë në Gjykatën Themelore për vazhdimin e masës së paraburgimit edhe për dy muaj për parashtruesin e kërkesës. Gjykata Themelore kishte miratuar kërkesën e PTHGJ-së dhe kishte vazhduar paraburgimin edhe për dy muaj për parashtruesin e kërkesës, duke arsyetuar se në rastin konkret ishin përmbushur kushtet për vazhdimin e paraburgimit të parapara sipas nenit 188 (Vazhdimi i paraburgimit) lidhur me nenin 184 paragrafi 1, nënparagrafët 1.1 dhe 1.2, pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPPRK-së. Pas ankesës së parashtruesit në Gjykatën e Apelit, i cili e kundërshtonte aktvendimin e shkallës së parë në të gjitha pikat, kjo e fundit refuzoi në tërësi ankesën, duke e mbështetur vendimin e shkallës së parë.
43. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në mënyrë shprehimore para Gjykatës konteston vendimet e gjykatave të rregullta me të cilat i është vendosur dhe vazhduar masa e paraburgimit, respektivisht Aktvendimin [PN1.DKR.nr.666/2023] të 26 qershorit 2023 të Gjykatës së Apelit, dhe Aktvendimin [PN1. DKR.nr.839/2023] të 10 gushtit 2023 të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar se i janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së.
44. Në dritën e kësaj, Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me pretendimin e tij se në rastin konkret, Gjykata e Apelit si në procedurën e zhvilluar për caktim të paraburgimit edhe në procedurën për vazhdim të tij, nuk kishte vendosur lidhur me ankesën e parashtruesit në afatin e paraparë ligjor prej 72 orëve, të përcaktuar sipas paragrafit 3 të nenit 186 (Përmbajtja e aktvendimit për caktimin e paraburgimit dhe ankesa kundër tij) të KPPRK-së gjë që, sipas parashtruesit të kërkesës ka rezultuar në shkeljen e garancive procedurale të përcaktuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së.
45. Edhe pse parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata vëren se pretendimet e tij në lidhje me vazhdimin e paraburgimit bien në kuadër të nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës dhe nenit 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së, dhe se pretendimin e lartcekur të parashtruesit të kërkesës Gjykata do ta shqyrtojë në kontekst të së drejtës së tij për liri dhe siguri, të garantuar me nenin 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së. Në kuptim të kësaj, Gjykata thekson se të drejtat dhe standardet që duhet garantuar në rastin e privimit nga liria janë interpretuar gjerësisht nga GJEDNJ, përmes praktikës së saj gjyqësore, në harmoni me të cilën, Gjykata bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
46. Prandaj, përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së, Gjykata i referohet parimeve dhe standardeve të përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të vet Gjykatës, që kanë të bëjnë me caktimin e paraburgimit.

1.Kriteret lidhur me caktimin e paraburgimit

47. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që, për të qenë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në, arrestimi ose heqja e lirisë duhet të bazohet në një nga arsyet për heqjen e lirisë të parapara në nenin 29, paragrafin 1 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së.

48. Gjykata fillimisht rikujton nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], paragrafin 1, pikën 2 të Kushtetutës që përcaktojnë:

Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:

[...]

(2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;

[...].”

49. Së dyti, Gjykata po ashtu i referohet nenit 5. 1 (c) të KEDNJ-së i cili përcakton që:

“Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

[...]

c. kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t’u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një vepër penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj.”

50. Gjykata vëren, se në bazë të nenit 29, paragrafit 1, pikës 2 të Kushtetutës dhe nenit 5. 1 (c) të KEDNJ-së, privimi i lirisë mund të bëhet në rast të dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale dhe kur një gjë e tillë konsiderohet e domosdoshme për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale ose largimin pas kryerjes së saj (shih rastet e Gjykatës, [KI85/22](#), parashtrues *Jadran Kostić*, Aktgjykim i 26 prillit 2023, paragrafi 68; dhe [KI10/18](#), parashtrues *Fahri Deqani*, Aktgjykim i 8 tetorit 2019, paragrafi 65).
51. Prandaj, Gjykata thekson që për të qenë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në, caktimi i paraburgimit duhet të ketë mbështetje në njërin nga bazat për privimin e lirisë të përcaktuara me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 5, paragrafin 1 (c) (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së.
52. GJENDJ-ja, në praktikën e saj gjyqësore, ka përcaktuar tri kritere themelore që duhet ekzaminuar për të vlerësuar nëse privimi i lirisë është i ligjshëm dhe joarbitrar, kritere këto të afirmuara edhe përmes praktikës gjyqësore të vet Gjykatës (shih rastin e GJEDNJ-së, [Merabishvili kundër Gjeorgjisë](#), nr. 72508/13, Aktgjykim i 28 nëntorit 2017, paragrafi 183, shih rastet e Gjykatës [KI85/22](#), parashtrues *Jadran Kostić*, cituar më lart, paragrafi 70; dhe [KI10/18](#), parashtrues *Fahri Deqani*, të cituar më lart, paragrafi 67).
53. Së pari, duhet të ekzistoj “*dyshimi i bazuar*” që një person i privuar nga liria ka kryer një vepër penale (shih, rastin e Gjykatës [KI85/22](#), parashtrues *Jadran Kostić*, i cituar më lart, paragrafi 71). Së dyti, qëllimi i privimit të lirisë “*është që në parim duhet të jetë në funksion të zbatimit të procedurës penale*” (shih, rastet e Gjykatës [KI63/17](#), parashtrues *Lutfi Dervishi*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 nëntorit 2017, paragrafi 57 dhe [KI10/18](#), parashtrues *Fahri Deqani*, cituar më lart, paragrafi 68; [KI85/22](#) parashtrues *Jadran Kostić*, cituar më lart, paragrafi 71; shih po ashtu rastin e

GJEDNJ-së, [Ostendorf kundër Gjermanisë](#), nr. 15598/08, Aktgjykim i 7 marsit 2013, paragrafi 68), dhe që për më tepër, duhet të jetë proporcional, në kuptimin që duhet të jetë i nevojshëm “për të siguruar paraqitjen e personit të afektuar para autoriteteve kompetente përkatëse” (shih, rastin e Gjykatës [KI85/22](#), parashtrues *Jadran Kostić*, i cituar më lart, paragrafi 71, shih po ashtu rastin e lartcekur të GJEDNJ-së [Merabishvili kundër Gjeorgjisë](#), paragrafi 185). Së treti, privimi i lirisë apo caktimi i paraburgimit duhet të jetë bërë duke ndjekur procedurën e përcaktuar me ligj (shih rastet e lartcekura të Gjykatës [KI85/22](#) parashtrues *Jadran Kostić*, cituar më lart, paragrafi 71; [KI10/18](#), parashtrues *Fahri Deqani*, cituar më lart, paragrafi 68 dhe rastin e lartcekur të GJEDNJ-së [Merabishvili kundër Gjeorgjisë](#), paragrafi 186).

1.1. Zbatimi i kriterëve lidhur me caktimin e paraburgimit në rastin e parashtruesit të kërkesës

54. Duke u bazuar në atë që u theksua me lart, Gjykata vëren që caktimi i paraburgimit në fjalë, është i bazuar në nenin 29.1.2 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5.1 (c) të KEDNJ-së

2.Parimet e përgjithshme në lidhje me ligjshmërinë e caktimit dhe vazhdimin e paraburgimit

55. Në këtë rast, Gjykata i referohet paragrafit 4 të nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës, i cili përcakton që “Çdokush që i hiqet liria më arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit”.
56. Përderisa paragrafi 4 i nenit 5 (E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë) të KEDNJ-s, përcakton që “Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm”.
57. Në këtë kuptim, fakti që Gjykata nuk ka konstatuar shkelje të kërkesës së paragrafit 1 të nenit 5 nuk e përjashton atë nga detyrimi për të shqyrtuar dhe elaboruar edhe pajtueshmërinë e paraburgimit me paragrafin 4 të nenit 29 të Kushtetutës në ndërlidhje me paragrafin 4 të nenit 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së (shih, rastin e Gjykatës [KI85/22](#), parashtrues *Jadran Kostić*, i cituar më lart, paragrafi 76; dhe rastet e Gjykatës [KI146/23](#) dhe [KI163/23](#), parashtrues *Nagip Krasniqi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 22 janarit 2024, paragrafi 109; si dhe rastin e GJEDNJ-së [Douiyeë kundër Holandës](#) , nr. 31464/96, Aktgjykim i 4 gushtit 1999, paragrafi 57).
58. Po ashtu, Gjykata bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ka theksuar se neni 29, paragrafi 4 Kushtetutës përcakton që çdo person i arrestuar ose i ndaluar ka të drejtën për të kërkuar nga gjykata që të shqyrtojë kërkesat procedurale dhe ato përmbajtësore e që janë thelbësore për “ligjshmërinë” e heqjes së lirisë ndaj tij në kuptimin e nenit 29, paragrafit 1 të Kushtetutës (shih, rastin e Gjykatës [KI85/22](#), parashtrues *Jadran Kostić*, i cituar më lart, paragrafi 77; dhe dhe rastet e Gjykatës [KI146/23](#) dhe [KI163/23](#), parashtrues *Nagip Krasniqi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 22 janarit 2024, paragrafi 110; si dhe ndër tjerash edhe rastet e GJEDNJ-së [Idalov kundër Ruisë](#), nr. 5826/03, Aktgjykim i 22 majit 2012, paragrafi 161; dhe [Reinprecht kundër Austrisë](#), nr. 67175/01, Aktgjykim i 15 nëntorit 2005, paragrafi 31).

59. Në këtë kuptim, nocioni i “*ligjshmërisë*” në kuptimin e paragrafit 4 të nenit 29 të Kushtetutës, ë ndërlidhje me paragrafin 4 të nenit 5 të KEDNJ-së ka të njëjtin kuptim si ai i paragrafit 1 të nenit 29 të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit të KEDNJ-së aq sa çdo person i arrestuar ose i ndaluar ka të drejtën për të kërkuar që të shqyrtohet ligjshmëria e arrestimit të tij jo vetëm në dritën e kriterëve të përcaktuara me ligj, por edhe në pajtim me parimet themelore të përcaktuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (shih, rastin e Gjykatës [KI85/22](#), parashtrues *Jadran Kostić*, i cituar më lart, paragrafi 78; dhe rastet e Gjykatës KI146/23 dhe KI163/23, parashtrues *Nagip Krasniqi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 22 janarit 2024, paragrafi 111, si dhe rastin e GJEDNJ-së [Suso Musa kundër Maltës](#), nr. 42337/12, Aktgjykim i 23 korrikut 2013, paragrafi 50).
60. Prandaj për të përmbushur kërkesat e përcaktuara me nenin 29 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ-së, shqyrtimi nga ana e gjykatave të rregullta duhet të jetë në pajtueshmëri si me rregullat përmbajtjesore dhe ato procedurale të legjislacionit të zhvillohet në pajtim me qëllimin e nenit 29 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 5 të KEDNJ-së, përkatësisht mbrojtjen e individit nga arbitrariteti (shih, rastin e Gjykatës [KI85/22](#), parashtrues *Jadran Kostić*, i cituar më lart, paragrafi 79; dhe rastin e GJEDNJ-së [Koendjibiharie kundër Holandës](#), nr. 11487/85, Aktgjykim i 25 tetorit 1990, paragrafi 27).
61. Në këtë kuptim, Gjykata bazuar edhe në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme para saj, pretendimet e ngritura nga parashtruesit e kërkesës, që ndërlidhen me vendimmarrjen e gjykatave të rregullta për caktimin dhe vazhdimin e paraburgimit brenda afateve të përcaktuara me dispozitat e KPPRK-së i ka shqyrtuar në kuptim të garancive procedurale dhe atyre përmbajtësore përkitazi me ligjshmërinë e paraburgimit, në kuptim të paragrafit 4 të nenit 29 të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrafin 4 të nenit 5 të KEDNJ-së (shih, ndër tjerash rastet e Gjykatës [KI146/23 dhe KI163/23](#), parashtrues *Nagip Krasniqi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 22 janarit 2024, paragrafët 131-139).
62. Në vijim, Gjykata do të trajtojë pretendimet e lartcekura të parashtruesit duke u bazuar ne parimet dhe kriteret e shtjelluara më lartë, përkatësisht pretendimin e tij që ndërlidhet me vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit brenda afatit të përcaktuar prej 72 orëve, të përcaktuar sipas paragrafit 3 të nenit 186 (Përmbajtja e aktvendimit për caktimin e paraburgimit dhe ankesa kundër tij) të KPPRK-së .

(i) *Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e parashtruesit të kërkesës*

63. Në vijim, bazuar në shpjegimin e mësipërm të parimeve kryesore të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës ka dëshmuar dhe mbështetur mjaftueshëm pretendimet për shkeljen e garancive procedurale të përcaktuara në Kushtetutë dhe KEDNJ lidhur me ligjshmërinë e vazhdimin të paraburgimit të tij, përkatësisht lidhur me vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit brenda afatit të përcaktuar prej 72 orëve.
64. Rrjedhimisht, Gjykata në vijim do të shqyrtojë dhe elaborojë nëse vendimet e kontestuara përmes të cilave është caktuar dhe vazhduar paraburgimi ndaj parashtruesit të kërkesës kanë adresuar pretendimin thelbësor të tij, që ndërlidhet me vendimmarrjen e Gjykatës së Apeli brenda afatit prej 72 orëve, të cekur më lart.
65. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit që ndërlidhet me vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit brenda afatit të përcaktuar prej 72 orëve, të përcaktuar sipas paragrafit 3 të nenit 186 (Përmbajtja e aktvendimit për caktimin e paraburgimit dhe ankesa kundër

- tij) të KPPRK-së, respektivisht Aktvendimit [PN1.DKR.nr.666/2023] të 26 qershorit 2023 të Gjykatës Apelit me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar ankesa e parashtruesit kundër Aktvendimit [PPr.nr.2023:133768] të 15 qershorit 2023, me të cilin parashtruesit të kërkesës i ishte caktuar masa e paraburgimit, dhe Aktvendimit [PN1.DKR.nr.839/2023] të 10 gushtit 2023 të Gjykatës së Apelit me të cilin ishte refuzuar ankesa e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit [Ppr.Kr.nr.2023:133768] të 12 korrikut 2023 të Gjykatës Themelore, me të cilin parashtruesit të kërkesës i ishte vazhduar masa e paraburgimit.
66. Gjykata rikujton se kishte kërkuar sqarime nga Gjykata e Apelit lidhur me këtë çështje, dhe se më 22 janar 2024, Gjykata e Apelit dorëzoi para Gjykatës dokumentet relevante lidhur me rastin.
 67. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ankesën kundër Aktvendimit [PPr.nr.2023:133768] të 15 qershorit 2023 të Gjykatës Themelore, në Gjykatën e Apelit e kishte parashtruar më 16 qershor 2023. Më pas Prokuroria e Apelit më 23 qershor 2023 përmes shkresës [PAR/I.nr.774/2023] i kishte propozuar Gjykatës së Apelit që të refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruesit të kërkesës, ndërsa aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.
 68. Gjykata e Apelit kishte vendosur lidhur me ankesën e parashtruesit me Aktvendimin [PN1.DKR.nr.666/2023] më 26 qershor 2023, pas pranimit të parashtrësës së Prokurorisë së Apelit, ashtu edhe siç parashihet me paragrafin 3 të nenit 186 (Përmbajtja e aktvendimit për caktimin e paraburgimit dhe ankesa kundër tij) të KPPRK-së.
 69. Po ashtu, edhe sa i përket procedurës së vazhdimit të paraburgimit, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ankesën kundër Aktvendimit [Ppr.Kr.nr.2023:133768] të 12 korrikut 2023 të Gjykatës Themelore përmes të cilit parashtruesit të kërkesës i ishte vazhduar masa e paraburgimit, e kishte parashtruar më 13 korrik 2023. Më pas Prokuroria e Apelit më 9 gusht 2023 përmes parashtrësës [PAR/I.nr.983/2023] i kishte propozuar Gjykatës së Apelit që të refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruesit të kërkesës, ndërsa aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.
 70. Edhe në rastin e dytë, Gjykata e Apelit kishte vendosur lidhur me ankesën e parashtruesit me Aktvendimin [PN1.DKR.nr.839/2023] më 10 gushtit 2023, pas pranimit të parashtrësës së Prokurorisë së Apelit, ashtu edhe siç parashihet me paragrafin 3 të nenit 186 (Përmbajtja e aktvendimit për caktimin e paraburgimit dhe ankesa kundër tij) të KPPRK-së.
 71. Bazuar në atë që u tha më lart, Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit ka vendosur brenda afatit të përcaktuar prej 72 orëve, të përcaktuar sipas paragrafit 3 të nenit 186 (Përmbajtja e aktvendimit për caktimin e paraburgimit dhe ankesa kundër tij) të KPPRK-së.
 72. Prandaj, nga sa më lartë, Gjykata konstaton se ky pretendim është qartazi i pabazuar për mungesë të dukshme/evidente të shkeljes ashtu siç është përcaktuar me rregullin 34 të Rregullores së punës.
 73. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se Gjykata Supreme ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 dhe 32 të Kushtetutës për shkak të vonesës në vendosje në lidhje me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata vëren se Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës nuk përcakton asnjë afat të caktuar brenda të cilit Gjykata Supreme duhet të vendosë në lidhje me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë. Me këtë konstatim, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i

parashtruesit është i pabazuar në mungesë të një baze ligjore të qartë që të mbështesë pretendimin për shkelje të të drejtave kushtetuese në fjalë.

74. Gjykata vëren se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] ndërlidhet me pretendimin e tij për shkelje të nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës përkitazi me vendimet e kontestuara, për të cilat Gjykata vlerësoi se i plotësojnë kriteret e parapara për të drejtën për liri dhe siguri.
75. Më tej, Gjykata duke u bazuar në praktikën gjyqësore thekson se paragrafi 4 i nenit 29 të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrafin 4 të nenit 5 të KEDNJ-së përmban garanci specifike procedurale sa i përket kufizimit të lirisë që janë të ndara nga garancitë procedurale të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës sa i përket të drejtës për gjykim të drejtë. Për këtë arsye, neni 29, paragrafi 4 i Kushtetutës dhe neni 5, paragrafi 4 i KEDNJ-së është *lex specialis* në raport me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës. Rrjedhimisht, Gjykata nuk do t'i shqyrtojë ndaras shkeljet e pretenduara në lidhje me nenet 31 dhe 32 të Kushtetutës (shih, rastet e Gjykatës [KI63/17](#), parashtrues *Lutfi Dervishi*, cituar më lart, paragrafi 77 dhe [KI146/23 dhe KI163/23](#), parashtrues *Nagip Krasniqi*, i cituar më lart, paragrafi 139; si dhe rastin e GJEDNJ-së [Reinprecht kundër Austrisë](#), nr. 67175/01, Aktgjykim, i 15 nëntorit 2005, paragrafi 55).
76. Prandaj, bazuar në si më sipër, Gjykata, duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij se procedurat pranë gjykatave të rregullta në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se përmes vendimit të kontestuar i janë shkelur të drejtat e mbrojtura me Kushtetutë.
77. Rrjedhimisht, pretendimet e parashtruesit janë qartazi të pabazuara për shkak të mungesës të dukshme të shkeljes dhe si të tilla duhet të deklarohen të papranueshme në pajtim me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.

Kërkesa për mos zbulim të identitetit

78. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar mos zbulim të identitetit të palëve në procedurë, ku lidhur me kërkesën për mos zbulim të identitetit arsyeton si në vijim: “... Duke pasur parasysh që në këtë çështje janë të përfshirë palë të mitura dhe te pandehurit janë në një moshe të re dhe në rast të publikimit të emrit të parashtruesit të kërkesës me hulumtimin në google do të shfaqej emri i tij në këtë çështje, me vlerësimin e fazës së procedurës duke pasur parasysh dhe prezumimin e pafajësisë i lutem gjykatës mos të publikoj emrat e palëve të përfshira në këtë çështje penale”.
79. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet rregullit 24 (1) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Kurdo përgjatë procedurës së shqyrtimit të një kërkesë individuale sipas paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe deri në publikimin e vendimit përfundimtar, palët mund të kërkojnë që identiteti i tyre të mos zbulohet publikisht. Kërkesa duhet të jetë e arsyetuar”.

80. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 8 (1) të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, që përcakton:

“Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, sipas ligjit, pa ndërhyrje të paligjshme.”

81. Gjykata vëren se në këtë rast parashtruesi i kërkesës akuzohet me veprën penale të dhunimit dhe se pala e dëmtuar në rast ishte e mitur, dhe me këtë Gjykata konsideron se në një rast të tillë ku kemi të bëjmë me veprën penale të dhunimit, publiciteti mund, madje edhe në mënyrë të tërthortë, të ndikojë në identitetin, emrin dhe marrëdhëniet familjare të viktimës së mitur.

82. Prandaj, në pajtim me nenin 8 (1) të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe rregullin 24 (1) të Rregullores së punës, Gjykata miraton kërkesën e parashtruesit për moszbulimin e identitetit të tij dhe të palëve në procedurë publikisht.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 24 (1), 34 (2), si dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 4 shtator 2024 njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË APROVOJË kërkesën për moszbulim të identitetit;
- III. TË UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit; dhe
- V. TË KONSTATOJË që ky vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Enver Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Çaka-Nimani

